

Mundësi për aplikim në thirrjen “A European Collaborative Cloud for Cultural Heritage – Innovative tools for digitisation and analysis of dynamic processes, objects and complex combined data - HORIZON-CL2-2024-HERITAGE-ECCCH-01” nën Programin Horizon Europe

Synimi i Thirrjes:

Kjo thirrje synon zhvillimin dhe implementimin e mjeteve dhe metodave inovative në kuadër të “Reve Bashkëpunuese Europiane për Trashëgiminë Kulturore” (European Collaborative Cloud for Cultural Heritage) (ECCCH) për digjitalizimin dhe analizën e proceseve dinamike, objekteve dhe të dhënave komplekse. Kjo thirrje ofron një mundësi për të kontribuar në zhvillimin e trashëgimisë kulturore përmes teknologjisë dhe inovacionit.

Projektet duhet të adresojnë përdorime konkrete në fushat e mëposhtme:

- Digjitalizimi i objekteve dinamike, proceseve dhe praktikave.
Të zhvillohen qasje të reja për kapjen e karakteristikave mekanike dhe dinamike të objekteve dhe praktikave të trashëgimisë kulturore.
- Monitorimi i statusit të objekteve të trashëgimisë kulturore në kohë.
Të krijohen teknologji të integruara që mundësojnë ndjekjen e ndryshimeve të ngadalta ose të shpejta në objekte të ndryshme, duke përdorur AI dhe ekspertizë njerëzore për verifikim.
- Ndërveprimi dhe kombinimi i tipeve të ndryshme të të dhënave.
Të zhvillohen mjete që lehtësojnë ndërveprimin me përmbajtje digjitale duke ndihmuar krijimin e metodave të reja për analizë dhe prezantim.

Rezultatet e Pritshme:

- Përdorim i gjerë i ECCCH nga profesionistë dhe studiues të trashëgimisë kulturore në Europë për digjitalizim dhe monitorim.
- Përmirësim i ndërveprimit dhe rritje e mundësive për kombinimin e të dhënave për analiza dhe përfaqësime më të thella.
- Informacion dhe module trajnimi për përdoruesit mbi metodat dhe mjetet e reja të zhvilluara.

Karakteristikat Kryesore:

- Të gjitha mjetet e zhvilluara duhet të jenë open source dhe të integrohen në platformën ECCCH.
- Të sigurohet lehtësi e përdorimit dhe aksesueshmëri online për të gjitha palët e interesuara.
- Të zhvillohen studime rasti për të promovuar përdorimin dhe ripërdorimin e mjeteve në kontekste të tjera.

Kriteret e Konsorciumit:

Të përfshihen të paktën **3 entitete** ligjore të pavarura nga vende të ndryshme të BE-së ose vende të asociuara, të paktën **1 nga Vendet Anëtare** dhe **2 nga Vendet Anëtare dhe Vendet e asociuara**.

Buxheti:

Buxheti total për këtë thirrje është **12 milionë euro** dhe thirrja do të financojë **2 projekte** me grante që variojnë nga **5 deri në 6 milionë euro për projekt**.

Mënyra e Aplikimit:

Aplikimi kryhet përmes portalit të BE-së për Financime dhe Tendera dhe afati i fundit për dorëzimin e projekt-propozimeve është më datë **22 Janar 2025, ora 17:00 (ora e Brukselit)**

Link i Thirrjes:

<https://ec.europa.eu/info/funding-tenders/opportunities/portal/screen/opportunities/topic-details/HORIZON-CL2-2024-HERITAGE-ECCCH-01-01?isExactMatch=true&status=31094501,31094502&frameworkProgramme=43108390&callIdentifier=HORIZON-CL2-2024-HERITAGE-ECCCH-01&order=DESC&pageNumber=1&pageSize=50&sortBy=startDate>